

**STATUT  
DHE AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ L.F.T.B ” SH.P.K.**

**KAPITULLI I  
EMRI, FORMA E SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi**

1. Sot, më date 05.02.2014, krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ L.F.T.B ” sh.p.k., (ketu me poshtë e quajtur “ Shoqëria”);
2. Themeluesi dhe ortakut i vetëm i Shoqërisë është :  
- **Z. Ledion BREGU**, shtetas shqiptar, lindur më datë 06.06.1977 në K orçe, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 028392992 , banues në adresën Rr. : “Sotir Gura “ L 2 Nr 20, Korçe, Shqipëri, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar, dhe
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
4. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e parashikuara nga ky Statut dhe Akti i Themelimit të saj.

**Neni 2**

**Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: RR.NACIONALE KORCE – TIRANE KM 2, Korçe , Shqipëri.
2. Shoqëria mund të themelojë degë, zyrë përfaqësuese, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

**Neni 3**

**Objekti**

1. Objekti i Shoqërisë do të përfshijë por pa u kufizuar në, aktivitetet e mëposhtme:  
(a) Furnizimi i shërbimeve të kohës së lirë dhe kënaqësisë duke përfshirë shërbime bar, kafene, restorant, kalcet, etj Blerja, shitja, shkëmbimi apo kalimi në çfarëdo lloji mënyrë tjetër të lejuar nga ligji i pasurive të paluajtshme, apo të drejtave reale të lidhura me to, qofshin këto ekzistuese apo të ardhshme, të krijuara rishtazi apo të fituara nga të tjerë. Dhenia me



qera, huapërdorje, uzufukt apo kalimi në cfaredolloj mënyre tjetër të lejuar nga ligji i të drejtës posedimore të pasurive të paluajtshme apo të drejtave reale të lidhura me to, Import-eksport, blerje, shitje, shkëmbim, dhënia me qera apo huapërdorje të veshjeve të ndryshme. Furnizimi i shërbimeve të estetikës. Pjesëmarrja në investime industriale e tregtare, themelimi i shoqërive në formën e joint venture ose ortakëri me pale të treta. Shitja e blerja e kuotave/aksioneve të shoqërive të tjera, marrja ose dhënia e huave, vendosja e hipotekave, pengjeve, barreve siguruese ose mjeteve të tjera të garancisë, regjistrimi i markave tregtare, transferimi i cdo licenese, patente dhe know-how etj.

3. Për më tepër, Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në dësh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### Neni 4

##### Kohezgjatja

1. Kohezgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
2. Vendimi për prishjen e Shoqërisë merret nga Asambleja e Përgjithshme ose Ortaku i vetëm.

## KAPITULLI II KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E KAPITALIT

#### Neni 5

##### Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1000,00 Leke (njemijë Leke) i ndarë në 10 pjesë me vlerë nominale 100,0 leke (njëqind Leke) secila.
2. Pjesët e kapitalit themeltar të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas ligjit shqiptar në fuqi, përveç rastit të përcaktuar në nenin 6 të këtij akti.
3. Ortaku i vetëm i Shoqërisë është :
  - **Z. Ledion BREGU**, shtetas shqiptar, lindur më datë 06.06.1977 në Korçë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 028392992, banues në adresën Rr. : "Sotir Gura " L 2 Nr 20, Korçë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar, ortak i Shoqërisë dhe zoterues i 100% të kuotave të kapitalit themeltar të kësaj të fundit, dhe
4. Ortaku i Shoqërisë dhe Ortaket e Shoqërisë nëse hyjnë në Shoqëri përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të saj.



## Neni 6

### **Transferimi tek personat e tretë**

1. Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, me shitje ose me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Administratorit. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.
2. Kuotat mund janë të transferueshme tek të tretët, vetëm pas miratimit nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

## KAPITULLI III ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

### Neni 7

#### Asambleja e Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme ose Ortaku i vetem i Shoqërisë, ligjërisht e thirrur dhe rregullisht e mbledhur, përfaqëson unanimitetin e ortakëve dhe është organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e saj të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të këtij Statuti janë të detyrueshme për të gjithë ortakët qofshin të pranishëm ose jo, në favor ose kundër;
2. Asambleja e Pergjithshme ka keto funksione:
  - Përcakton politikën tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikeqyr zbatimin e tyre nga Administratori përfshi raportimet financiare;
  - Emeron dhe shkarkon Administratorin;
  - Emeron dhe shkarkon ekspertin(et) kontabel dhe/ose likuiduesin(t) e Shoqërisë;
  - Përcakton e pagat dhe shpërblimet për Administratorin, ekspertet kontabel dhe likuiduesit;
  - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
  - Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
  - Merr vendim për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendeve;
  - Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
  - Merr vendim për pjestimin e kuotave;
  - Merr vendim për hapjen e degeve dhe/ose zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
  - Merr vendim për themelimin e shoqërive të reja Joint Venture ose aleanca që lidhen me shitjen blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese dhe të reja;





- Vendors per dhenien dhe marrjen e fondeve hua ose paradhanie nga ortakët dhe administratorët për nevojat personale dhe për financim biznesi;
- Miraton kërkesat e reja dhe vëndos për rinovimin e kërkesave ekzistuese për financim;
- Vendors për bllokimin dhe lenien peng të pasurive të paluajtshme në ZRPP;
- Vendors për emërimin dhe shkarkimin e Menaxherve të Financës dhe zëvendësve të Administratorit;
- Miraton buxhetin vjetor të shoqërisë;
- Miraton investimet dhe shpenzimet të cilat nuk ishin parashikuar në buxhetin vjetor;
- Vendors për blerjen e pasurive të paluajtshme;
- Aproximin e planit të kontrollit të brendshëm të Shoqërisë;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuara nga ligji.

## Neni 7

### Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme ose e Ortakut te vetem

1. Ortaku i vetem i Shoqërisë kryen i vetem të gjitha procedurat e mëposhtme deri në momentin e futjes të ortakëve të tjerë në shoqëri .
2. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga një a me shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë;
4. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme të renditura në pikën 2 të nenit 7 me sipër, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
5. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 3 dhe 4 të këtij neni, Asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
6. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vëndosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
7. Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër ligjore të parashikuar në ligj, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërisë, konsiderohen vendime të jashtëzakonshme. Vendimet e jashtëzakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 75% të gjithë kuotave të kapitalit të Shoqërisë.



## Neni 8

### Regjistri i Vendimeve

1. Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme ose Ortaku i vetem i Shoqerise duhet te regjistrohen ne Regjistrin e Vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen. Regjistri i Vendimeve duhet te mbahet nga Administratori, dhe çdo regjistrim duhet nenshkruar nga Administratori.

## Neni 9

### Administratori

#### 9.1 *Administratori dhe mandati perkates*

1. Shoqeria administrohet nga 1 (nje) ose me shume Administrator/e i/te emeruar nga Asambleja e Pergjithshme ose Ortaku i vetem . Veprimet e administrimit të Shoqërisë do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga Administratorët bashkërisht.
2. Administratori/ët emërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi, me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 75% te kuotave të kapitalit të Shoqërisë.
3. Administratori i pare i Shoqerise eshte **Z. Ledion BREGU**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili ne te njejten kohe eshte njekohesisht dhe Ortaku i vetem i Shoqerise .
4. Mandati i Administratorit eshte 5 (pese) vjet, i rinovueshem, dhe zgjatet deri ne vendimin pasardhes te Asamblese se Pergjithshme, qe vendos per revokimin, rinovimin e mandatit te tij apo emerimin e administratorit (eve) te ri.

#### 9.2 *Te drejtat e Administratorit*

1. Shoqeria perfaqesohet ndaj te treteve nga Administratori.
2. Administratori ka te drejtat dhe detyrimet e meposhtme:
  - Aministron veprimtarine e Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
  - Perfaqeson Shoqerine ne marredhenie me çdo pale te trete.
  - Merr masa per hartimin dhe mbajtjen ne menyren e duhur te pasqyrave financiare dhe te dokumentave.
  - Pergatit dhe nenshkruan pasqyrat financiare vjetore dhe bilancet e konsoliduara, pergatit raportin e ecurise dhe ia dorezon keto te fundit bashke me propozimin perkates per shperndarjen e fitimeve Asamblese se Pergjithshme per miratim.
  - Krijon sistemin e paralajmerimit ne lidhje me rrethana, qe kercenojne veprimtarine e Shoqerise.



- Dorezon ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dokumentat dhe te dhenat e Shoqerise, pervec rasteve kur ligji parashikon ndryshe.
  - I raporton Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise dhe ne lidhje me permbushjen e transakcioneve te nje rendesie te vecante per ecurine e Shoqerise.
  - Kryen çdo detyre tjeter te parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
3. Administratori mund te autorizojë nepermjet nje prokure nje person te trete per te perfaqesuar Shoqerine dhe per te nenshkruar çdo dokument, kerkese ose aplikim ne emer dhe per llogari te Shoqerise.
  4. Adminstratori eshte pergjegjes ndaj Shoqerise per çdo dem te shkaktuar si pasoje e mospermbushjes se detyrimeve te parashikuara nga dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionit ne fuqi.

#### **Neni 10**

##### **Eksperti(et) Kontabel te Jashtem**

1. Pasqyrat financiare te Shoqerise do te auditohen te pakten nje here ne vit nga nje, apo me shume, ekspert kontabel te jashtem. Me marrjen ne dorezim te raportit perkates te auditimit, Adminstratori i Shoqerise do te marre te gjitha masat perkatese per ndreqjen e parregullesive te konstatuara nga raporti.

#### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR – SHPERNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 11**

##### **Viti Financiar**

1. Viti financiar fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor te çdo viti kalendarik. Ne perfundim te vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare te Shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### **Neni 12**

##### **Shperndarja e Fitimeve**

1. Pas miratimit te pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Pergjithshme ose Ortaku i vetem vendos ne lidhje me shperndarjen ose jo te fitimit, nese ka.



**KAPITULLI V**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

**Neni 13**

**Prishja dhe Likuidimi**

1. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme ose Ortaku i vetem vendos per prishjen e Shoqerise, do te emerohen nje ose me shume likuidues.
2. Eksperti kontabël i Shoqerise do te emerohet nga Asambleja e Pergjithshme ose Ortaku i vetem nese emerimi i tij eshte i detyrueshem ne baze te legjislacionit ne fuqi. Mandati i Ekspertit kontabel eshte i rinovueshem me vendim te Asamblese se Pergjithshme ose Ortakut te vetem .

**KAPITULLI VI**  
**DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

**Neni 14**

**Ligji i Zbatueshem**

1. Per te gjitha çeshtjet qe nuk parashikohen ne kete Statut do te zbatohen dipozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne lidhje me shoqerite tregtare.

**Neni 15**

**Te Ndryshme**

1. Ky Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "L.F.T.B " sh.p.k. përpilohet ne kater (4) kopje ne gjuhen shqipe, qe nënshkruhet rregullisht nga Ortaku i vetem Shoqerise.

**Ortaku i vetem i Shoqerise**

**Ledion BREGU**

LEDION BREGU

